

VENDIM
Nr. 25, datë 9.1.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE TË
BASHKISË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të pronave të paluajtshme shetëtare, me nr. pasurie 8/637, me sipërfaqe 23 (njëzet e tre) m², dhe 8/638, me sipërfaqe 2 400 (dy mijë e katërqind) m², të ndodhura në zonën kadastrale 8270, indeks harte TR – U, V-9,10, rruga “Anton Ashta”, pjesë e pasurisë me nr. 8/72, me nr. rendor 264, në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të inventarit të pronave të paluajtshme shetëtare, që janë në juridiksionin territorial dhe administrim të Bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës”.

2. Prona e paluajtshme shetëtare me nr. rendor 276 “Cirku i Tiranës”, në juridiksion të Bashkisë Tiranë, e kaluar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas vendimit nr. 458, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, t’i kalojë në pronësi Bashkisë Tiranë.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Bashkia Tiranë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHPJEGJESE

ZK. 8270

TR- U, V- 9, 10

Rr. "Anton Ashta"

Shk. 1: 500

Pronë e identifikuar për vendosjen e Cirkut Kombëtar.

GJERËSI = 45 M

GJATËSI = 50 M

SIPËRFAQE TOT. TR. = 2347.5 M²

8/72

